



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 256/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Istog, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës e Kosovës (LDK), dega në Istog, për shkak thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me dt.12.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Istog.

Arsyetim

PZAP-i, më datë 08.06.2014 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik PDK dega në Istog, thekson se aktivistët e PDK-së, kanë vërejtur se në qendrën e votimit 0604c në shkollën fillore “ Martin Camaj” në Gurakoc, komuna e Istogut rreth orës 16:40, aktivisti i LDK-së ka vendosur flamurin LDK-së, mbi veturë dhe ka hyrë në oborrin e shkollës ku është qendra e votimit, me qëllim të bërjes së fushatës.

Parashtruesi i ankesës ka pretenduar se subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 36 paragrafi 1 pika a) dhe b) e Ligjit nr .03/L-073. Në cilësi të provës ka bashkangjitur fotografinë nga vendi i ngjarjes i pretenduar në ankesë.

PZAP-i, në kuptim të nenit .4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK me datë 09.06.2014, për ankesën që është bërë ndaj saj nga ana e PDK-së dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 10.06.2014 në ora 09:00. PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga PDK, në të cilën theksohet se ankesa e cila është bërë kundër subjektit të tyre e konsiderojnë si të pabazuar nga fakti se fotot e bashkangjitura si provë nuk vërtetojnë datën dhe orën e ngjarjes së ndodhur të supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Nga fotografia e ofruar si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nuk mund të vërehet dhe nuk mund të vërtetohet ajo për të cilin pretendon pala ankuese në

ankesën e saj, pasi që nga fotografia e ofruar si dëshmi nuk mund të vërtetohet ora dhe ngjarja e supozuar . Një pretendim të tillë ankimor PZAP-i e konstatoi si të përgjithshëm dhe të pabazuar për tu administruar si provë relevante, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 256/2014 më datën 12.06.2014



**Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha**

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*